

1 E martë, 10 maj 2022

2 [Paraqitje e mëtejshme]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 10.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve.

7 Mirë se erdhët, qoftë nëse jeni në sallën e gjyqit ose jashtë
8 saj.

9 Ju lutem znj. Sekretare, paraqisni lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
12 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
13 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
15 Sekretare.

16 Tani ju lutem palëve të paraqiten.

17 Të fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

18 Z. Prokuror.

19 Z. TIEGER: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve. Unë jam
20 Alan Tieger dhe Dounia Hattabi përfaqësojmë Zyrën e Prokurorit
21 të Specializuar.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

23 Tani Mbrojtja.

24 Z. Kehoe, mikrofonin ju lutem.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë jam

1 Gregory Kehoe dhe së bashku me z. Dastid Pallaska përfaqësojmë
2 z. Hashim Thaçi.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vërej që z. Thaçi e ndjek
4 seancën me anë të videolidhjes.

5 Mbrojtësi i Viktimave.

6 Z. Law

7 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë jam Simon
8 Laws. Jam Mbrojtësi i Viktimave në këtë çështje gjyqësore.
9 Mund të prezantoj edhe bashkëmbrojtësen, Maria Radziejowska që
10 është në sallën e gjyqit bashkë me ju aty.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Law.

12 Tani i kthehem Zyrës Administrative.

13 Z. NILSSON: [Përkthim] Unë jam Jonas Nilsson i Zyrës së
14 Shërbimeve Gjyqësore.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Me 3 shtator 2021,
16 Prokurori i Specializuar bëri një kërkesë për të amenduar
17 aktakuzën në bazë të rregullës 90(1)(b).

18 Prokuroria paraqiti tre kategori ndryshimesh. Kategoria e
19 parë përbëhej nga dy qendra ndalimi në komunën e Suharekës në
20 ose në lidhje me anëtarët e UÇK-së që janë - ku janë anëtarë
21 të UÇK-së kanë kryer akte të përndjekjes, të burgosjes apo të
22 ndalimit arbitrar, akte të tjera çnjerëzore, trajtim
23 çnjerëzor, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë.

24 Kategoria e dytë kishte të bënte me dy incidente të
25 përndjekjes dhe vrasjes së paligjshme të kryera në një qendër

1 ndalimi në komunën e Gjilanit dhe modifikimin e kohës kur kanë
2 ndodhur këto.

3 Dhe kategoria e tretë përbëhej nga dy incidente për
4 pjesëmarrje personale të të akuzuarit në krimet e kryera.

5 Më 23 dhjetor 2021, unë lëshova vendimin e parë ku dhashë
6 miratimin për ndryshimin e aktakuzës në lidhje me kategorinë e
7 tretë të ndryshimeve të propozuara që unë mendova se nuk
8 përbënin ndryshime -- nuk përbënin akuza të reja.

9 Më tej, unë konstatova se kategoritë e para dhe të dyta
10 të ndryshimeve ishin akuza të reja dhe duhej të vlerësoheshin
11 në bazë të standardit të kërkuar të provës të dyshimit të
12 mirëbazuar, sipas rregullës 86(4) të Rregullores nën dritën e
13 provave të dorëzuara sipas rregullës 86(3).

14 Palët u urdhëruan që të bënin -- të jepnin përgjigjet e
15 tyre dhe t'i përgjigjeshin pyetjes nëse materiali mbështetës
16 për ndryshimet përbënte akuza të reja dhe a e mbështesin ato
17 konstatimin për dyshim të mirëbazuar në bazë të rregullës
18 86(4).

19 Më 22 prill 2022, konfirmova kategorinë e parë dhe të
20 dytë të ndryshimeve dhe akuzat që përmbaheshin aty. Unë
21 gjithashtu urdhërova ZPS-në që të dorëzonte deri më 29 prill
22 2022, një aktakuzë të ndryshuar me kategorinë e parë dhe të
23 dytë të ndryshimeve.

24 Me 29 prill ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar, një
25 version më pak të redaktuar dhe versionin publik të redaktuar

1 të përmbledhjes së provave të kategorisë së parë dhe një
2 version publik të redaktuar dhe një version konfidencial të
3 përmbledhjes për kategorinë e dytë.

4 Me 2 maj 2022, unë caktova datën për këtë seancë të
5 paraqitjes vijuese.

6 Përpara se të vazhdoj, znj. Sekretare a mund të
7 kontrolloni me qendrën -- me njësinë e paraburgimin nëse z.
8 Thaci është aty.

9 Atëherë më lejoni të shpjegoj qëllimin e kësaj seance
10 vijuese për të akuzuarin dhe ata që na ndjekin në galerinë
11 publike apo në internet.

12 Sot nuk kemi gjykim. Nuk do të paraqiten prova apo të
13 debatohen provat dhe nuk do të diskutohet, as nuk do të
14 vendoset për fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.

15 Qëllimi i kësaj Seance të Mëtejshme rregullohet me nenin
16 39 të Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores. Në pajtim me
17 këto dispozita, unë si Gjykatës i Procedurës Paraprake, ja
18 lexoj të akuzuarit akuzat e paraqitura në akuzën e ndryshuar
19 në një gjuhë që e kupton dhe flet; konfirmoj nëse ai e kupton
20 aktakuzën; bindem se të drejtat e të akuzuarit dhe veçanërisht
21 e drejta e tij për të pasur avokat respektohet; dhe informoj
22 të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga seanca e sotme ai do të
23 ftohet të vetëdeklarohet fajtor ose jofajtor në lidhje me
24 secilën aktakuzë të paraqitur në aktakuzën e ndryshuar.

25 Por, në qoftë se i akuzuari dëshiron ta bëjë këtë, ai

1 mund ta bëjë vetëdeklarimin që sot, menjëherë.

2 Dhe unë pres që palët t'u përmbahen këtyre pikave të
3 cilat do t'i trajtoj një nga një. Në qoftë se ndonjë nga palët
4 dëshiron të diskutojë ndonjë temë tjetër që nuk është paraparë
5 në rendin e ditës ata duhet të bëjnë paraqitjen me shkrim,
6 parashtrime me shkrim para meje.

7 Së pari z. Thaçi a mund t'ju pyes të konfirmoni që e keni
8 marrë aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar me datë 29 prill
9 2022?

10 Nuk ka zë. Ju lutem njësia e teknikëve të audio -- të
11 teknikës ju lutem shikon nëse punon zëri.

12 Z. Thaçi, tani është rregulluar zëri. Ju lutem do t'ju
13 pyes edhe një herë të konfirmoni nëse e keni marrë aktakuzën e
14 konfirmuar të datës 29 prill 2022?

15 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mikrofonit nuk
16 është i lëshuar si duket.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po. Më duket se mikrofonit
18 mbyllet këtu. Nuk e dëgjojmë.

19 [Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe
20 Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Teknikët po punojnë për ta
22 rregulluar lidhjen. Mund të duhen disa sekonda për ta
23 rregulluar.

24 Tani e dëgjoj që mikrofonit është i ndezur. Më në fund e
25 zgjidhëm problemin. Na falni për këtë ndërprerje.

1 Z. Thaçi a mund t'ju kërkoj të konfirmoni nëse e keni
2 marrë aktakuzën e konfirmuar të datës 29 prill 2022?

3 Z. Thaçi, më dëgjoni?

4 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Po.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë do t'ju pyes edhe
6 një herë. Do t'ju kërkoj edhe një herë që të konfirmoni nëse e
7 keni marrë aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar të datës 29
8 prill 2022?

9 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Po.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit.

11 Tani do t'i kërkoj Sekretares që të lexojë akuzat e reja
12 që përmban akuza e re e ndryshuar në bazë të rregullës -- të
13 nenit 39 të Ligjit dhe rregullës 92.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
15 Gjykatës mund t'i shpjegojmë këto gjëra. Ne nuk kemi nevojë të
16 lexohet kjo -- të lexohen elementet e rinj të aktakuzës. Nuk
17 është e nevojshme.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

19 Faleminderit.

20 Z. Thaçi jeni dakord që të mos lexohen akuzat sot, akuzat
21 e reja?

22 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Po.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Thaçi.

24 Atëherë do t'i kërkoj Sekretares që të mos i lexojë këto
25 akuzat e reja dhe ato mund të shikohen në internet nga

1 publiku.

2 Z. Thaçi dua t'ju kujtoj që kjo nuk është koha për të
3 kundërshtuar akuzat e reja, por thjesht për të pranuar që i
4 keni kuptuar këto akuza. Ju do të keni mundësi të plotë që t'i
5 kundërshtoni akuzat me ndihmën e avokatit tuaj.

6 Z. Thaçi a i kuptoni akuzat e reja që përmbahen në
7 aktakuzën e konfirmuar?

8 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Jo.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kur them "a i kuptoni", nuk
10 po pyes që a pajtoheni me to, por po ju pyes a i kuptoni se
11 çfarë duan të thonë ato?

12 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Nuk i kam kuptuar
13 për arsye se s'kam pasur mundësi me i lexuar sepse janë shumë
14 të redaktuara.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Problemi për
16 klientin tonë është që si shumica e këtyre akuzave, ato janë
17 shumë të redaktuara, emrat, vendet, kohët dhe kjo është njësoj
18 si dhe përpara dhe kjo e bën klientin tim, z. Thaçi dhe të
19 tjerët, të akuzuarit e tjerë që të mos kenë mundësi të
20 kuptojnë ekzaktësisht se çfarë saktësisht po paraqet Prokurori
21 i Specializuar.

22 Kjo është një vështirësi e vazhdueshme. Ata vazhdojnë të
23 shtojnë volume materialesh dhe -- me redaktime të shumta.
24 Redaktime të shumta ka pasur përpara dhe redaktime të shumta
25 po bëhen tani. Dhe në këtë moment nuk po shtohet ndonjë gjë e

1 madhe në këtë ekuacion. Se me këto redaktime është e pamundur
2 të kuptohet nga ai se për çfarë bëhet fjalë dhe ne i kemi
3 kaluar këto me z. Thaçi. I kemi diskutuar këto çështje dhe
4 kemi thënë që ai do të vetëdeklarohet i pafajshëm në këtë
5 moment.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Thaçi, doni të shtoni
7 ndonjë gjë për këtë temë?

8 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Jo, vetëm se
9 deklarohej i pafajshëm. Megjithëse lëndën s'e kam lexuar për
10 këtë arsye edhe s'e kam kuptuar, por deklarohej i pafajshëm.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju, i nderuar
12 Gjykatës, e kuptoni vështirësinë që ka kushdo person që mund
13 të lexojë diçka ku ka redaktime kaq të shumta në dokument.
14 Domethënë duke pasur parasysh këto redaktime, Presidenti Thaçi
15 po paraqet një vetëdeklarim, jofajtoj, pra i pafajshëm.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E them për publikun, që ka
17 redaktime vërtetë në aktakuzë dhe ato kryesisht kanë të bëjnë
18 me emrat e dëshmitarëve potencialë dhe viktimave potenciale
19 dhe këto janë autorizuar prej meje në vendimin që kam dhënë.

20 Tani do t'ju informoj për të drejtat që ju takojnë
21 përpara kësaj Gjykate z. Thaçi. Ligji për Dhomat e
22 Specializuara dhe Rregullorja garantojnë disa të drejta. Do
23 t'ju lexoj disa më të rëndësishmet.

24 E para, ju prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e
25 fajësisë përtej dyshimit të arsyeshëm.

1 Në marrjen e vendimit mbi akuzat kundër jush, ju keni të
2 drejtën e një gjykimi të drejtë në -- të drejtë dhe të shpejtë
3 në vartësi të masave të urdhëruara për mbrojtjen e viktimave
4 dhe dëshmitarëve.

5 Keni të drejtën të informoheni në kohë dhe hollësi në një
6 gjuhë që e kuptoni për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër
7 jush.

8 Keni të drejtën të keni kohë dhe mjete të mjaftueshme për
9 përgatitjen e mbrojtjes dhe të komunikoni me avokatin që e
10 zgjidhni vetë.

11 Keni të drejtën të gjykojeni brenda një periudhe të
12 arsyeshme.

13 Keni të drejtën të mbroheni përmes avokatit tuaj mbrojtës
14 dhe në praninë tuaj.

15 Keni të drejtën t'ju caktohet avokat pa pagesë, në qoftë
16 se nuk keni mjete për ta paguar atë.

17 Keni të drejtën që t'u bëni pyetje ose dikush tjetër t'u
18 bëjë pyetje në emrin tuaj dëshmitarëve si dhe të kërkoni
19 praninë edhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emrin tuaj.

20 Keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi falas, në
21 qoftë se nuk e kuptoni gjuhën që flitet në gjykatë.

22 Keni të drejtën të mos detyroheni të dëshmoni kundër
23 vetes apo të pranoni fajësinë.

24 Keni të drejtën të qëndroni i heshtur dhe asnjë përfundim
25 negativ nuk do të nxirret nga heshtja juaj.

1 Keni të drejtën të bëni deklaratat pa betim në lidhje me
2 çështjen tuaj dhe mund të paraqiteni edhe si dëshmitar nën
3 betim.

4 Keni të drejtën të bëni mocione paraprake.

5 Keni të drejtën të merrni materialin mbështetës për
6 aktakuzën e ndryshuar.

7 Keni të drejtën t'u jepen të gjitha deklaratat e
8 dëshmitarëve që Prokuroria synon t'i sjellë për të dhënë
9 dëshmi dhe t'i keni ato në një gjuhë që e kuptoni.

10 Keni të drejtën t'ju jepet menjëherë informacion i cili
11 në mënyrë të arsyeshme sugjeron pafajësinë tuaj ose lehtëson
12 fajësinë apo ndikon në kredibilitetin apo besueshmërinë e
13 provave të Prokurorit të Specializuar, sapo ky informacion të
14 jetë në ruajtjen, kontrollin dhe dijeninë e Prokurorit.

15 Keni të drejtën të dorëzoni të gjitha materialet dhe
16 provat përkatëse që ka Prokuroria që t'ju jepen përpara ose
17 gjatë procesit gjyqësor. Kjo e drejtë kufizohet vetëm me ato
18 masa që janë lehtësisht të nevojshme dhe kur zbatohen masa
19 mbrojtëse kompensuese.

20 Ju keni të drejtën të mos mbaheni për në periudhë të
21 paarsyeshme në paraburgim para hapjes së çështjes dhe të
22 kërkon rishqyrtimin e vendimeve në lidhje me paraburgimin tuaj
23 dhe t'i apiloni ato në Gjykatën e Apelit.

24 Keni të drejtën, së fundi, që të apiloni drejtpërdrejt në
25 Gjykatën e Apelit vendimet dhe mocionet paraprake.

1 Keni edhe të drejtën për leje për apelimin e vendimeve të
2 tjera.

3 Z. Thaçi ju i dëgjuar të drejtat më të rëndësishme që
4 gëzoni me kornizën ligjore në fuqi të Dhomave të
5 Specializuara.

6 A i keni kuptuar këto të drejta z. Thaçi?

7 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Po.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Thaçi.

9 Dua t'ju informoj që në bazë të nenit 21(5) e Ligjit ju
10 nuk mund të përfaqësoni veten sepse jeni në paraburgim. Është
11 i detyrueshëm përfaqësimi me avokat.

12 Megjithatë, vërej që ju sot përfaqësoheni nga avokati,
13 nga mbrojtësi juaj dhe jam i bindur që ju jeni i përfaqësuar
14 ashtu siç duhet për sot edhe në procedurat e tjera.

15 Tani, z. Thaçi unë do t'ju pyes zyrtarisht për të bërë
16 vetëdeklarimin, megjithatë e thatë më përpara. Keni 30 ditë
17 nga dita e sotme që të vetëdeklaroheni fajtor ose jofajtor.
18 Por nëse dëshironi mund ta bëni këtë vetëdeklarimin tani.

19 Pra, z. Thaçi tani do t'ju kërkoj që zyrtarisht të më
20 thoni nëse juve deklaroheni fajtor ose jofajtoj për akuzat e
21 reja që përmban aktakuza e konfirmuar e ndryshuar.

22 Z. Thaçi.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ka një problem
24 me zërin, me audion, por besoj që Gjykata mund ta pranojë që
25 ne të fusim vetëdeklarimin e z. Thaçi si jofajtor, si i

1 pafajshëm.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Thaçi keni fjalën.

3 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Z. Gjyqëtar, e
4 theksova edhe një herë, amendamentet tuaja shtesë janë të
5 redaktuara. Jam munduar t'i lexoj. Nuk kam arritur. Prandaj
6 edhe nuk i kam kuptuar. Por deklarohe i pafajshëm.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi. E
8 shënuam këtë.

9 Tani kam - dëshiroj t'i pyes palët nëse kanë ndonjë gjë
10 për të - ndonjë çështje tjetër për të ngritur.

11 E fillojmë me Prokurorin e Specializuar.

12 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk kemi asgjë, asnjë çështje për
13 të ngritur.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws

15 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo nuk kam
16 asgjë për të ngritur.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Vetëm
19 shkurtimisht për të thënë për procesverbalin që ende apeli që
20 kemi bërë për mangësitë në formën e aktakuzës është në Dhomën
21 e Gjykatës së Apelit dhe s'kemi marrë akoma përgjigje.

22 Po kështu, është edhe çështja tjetër e afateve kohore për
23 mocionet sipas rregullës 94, që është 21 ditë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, ashtu është. Nuk është
25 akoma e qartë se kur fillon data e -- për bërjen e apelit për

1 aktakuzën e ndryshuar, por afatet do të fillojnë nga dita e
2 sotme. Pra 21 ditë nga dita e sotme.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në rregull.
4 Faleminderit, megjithatë redaktimet janë kaq të shumta sa që
5 ndonjëherë nuk mund të shohësh fare se çfarë është aty.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.
7 Atëherë, nuk shikoj askënd tjetër që do të marrë fjalën.
8 Seanca mbyllet. Faleminderit.

9 --- Paraqitja e mëtejshme përfundon në orën
10 10.23

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25